



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Prokurori kundër Pjetër Shalës**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 10 nëntor 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Redaktuar Publik i**

**Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të të Akuzuarit**

Zhan Lui Zhilisen

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në pajtim me nenin 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, pas një vendimi të Gjykatësit të Procedurës Paraprake ("Vendimi i Konfirmimit"),<sup>2</sup> Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>3</sup>
2. Më 16 mars 2021, pas një vendimi dhe fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,<sup>4</sup> Pjetër Shala ("z. Shala" ose "i akuzuari") u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës ("Belgjika").<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u nxorën më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redakte dhe versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01, konfidencial, F00016/A02, publik. Versioni konfidencial me edhe më pak redakte i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 25 maj 2021, F00038/A01. Pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për mocionin e Mbrojtjes që kundërshton formën e Aktakuzës së Konfirmuar, u dorëzua një aktakuzë e korrigjuar më 1 nëntor 2021, F00098/A01, konfidenciale.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial. Një version i redaktuar publik u nxor më 6 maj 2021, F00008/RED. KSC-BC-2020-04, F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u nxor më 15 prill 2021, F00008/A01/RED.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

3. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në Hagë, Holandë.<sup>6</sup>
4. Më 15 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzoi kërkesën për lirim të përkohshëm të dorëzuar nga Mbrojtja e z. Shala ("Mbrojtja") ("Vendimi i Parë për Paraburgimin").<sup>7</sup> Më 20 gusht 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi Vendimin e Parë për Paraburgimin ("Vendimi i Gjykatës së Apelit").<sup>8</sup>
5. Më 10 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rishikoi paraburgimin e z. Shala dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij ("Vendimi i Dytë për Paraburgimin").<sup>9</sup>
6. Më 25 tetor 2021, meqë Mbrojtja nuk paraqiti parashtrime për rishikimin e paraburgimit të z. Shala në pajtim me afatin kohor të përcaktuar në Vendimin e Dytë për Paraburgimin,<sup>10</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") paraqiti parashtrimet e veta për rishikimin e paraburgimit të z. Shala ("Parashtrimet e ZPS-së").<sup>11</sup>
7. Më 1 nëntor 2021, Mbrojtja paraqiti parashtrimet e veta për rishikimin e paraburgimit të z. Shala ("Parashtrimet e Mbrojtjes").<sup>12</sup>

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me Shtojcat 1-2, konfidenciale. Një version i redaktuar publik u nxor më 26 prill 2021, F00019/RED.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-04, F00045, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm*, 15 qershor 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u nxor më 23 qershor 2021, F00045/RED.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-04, IA001/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm*, 20 gusht 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA001/F00005/RED.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-04, F00075, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 10 shtator 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u nxor po atë ditë, F00075/RED.

<sup>10</sup> Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 49(b).

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-04, F00093, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Rishikimin e Dytë të Paraburgimit*, 25 tetor 2021, publike; *shih gjithashtu*, Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 49(c).

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-04, F00099, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë për Rishikimin e Dytë të Paraburgimit*, 1 nëntor 2021, publike; *shih gjithashtu*, Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 49(c).

## II. PARASHTRIMET

8. ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit të z. Shala vijon të jetë i domosdoshëm dhe proporcional dhe i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të urdhërojë mbajtjen e tij të mëtejshme në paraburgim.<sup>13</sup> Për mendimin e ZPS-së, nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm të rrethanave që do t'i zhvlerësonte arsyet e përcaktuara për paraburgim, duke qenë se rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit janë të njëjtat ose janë shtuar që nga Vendimi i Parë dhe i Dytë për Paraburgimin.<sup>14</sup>

9. Mbrojtja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të urdhërojë menjëherë lirimin e përkohshëm të z. Shala, me ose pa kushte.<sup>15</sup>

## III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Neni 41(6) i Ligjit parashikon që DHS-ja urdhëron paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshim i bazuar se personi ka kryer një vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së, dhe kur ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) përbën rrezik arratisjeje; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e një veprë penale, ose rrethana specifike tregojnë se personi do të pengojë ecurinë e procedurës penale; ose (iii) do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale në tentativë, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

11. Neni 41(10) i Ligjit parashikon që, deri në kohën kur aktgjykimi të merr formën e prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve pas aktvendimit të fundit për paraburgim, gjykatësi i procedurës paraprake ose trupi gjykues i informuar për rastin shqyrton nëse ekzistojnë ende arsye për paraburgim

---

<sup>13</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 9.

<sup>14</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1.

<sup>15</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 6, 39.

dhe nxjerrin aktvendim për lirim apo ndërprerjen e paraburgimit. Kjo del edhe nga rregulla 57(2) e Rregullores.

12. Neni 41(12) i Ligjit parashikon që krahas paraburgimit mund të urdhërohen edhe masat e mëposhtme, për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale apo për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, paraburgimi shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve ose personave të caktuar, paraqitja në stacion të policisë apo në ndonjë vend tjetër, dhe masa alternative shmangëse.

13. Në pajtim me rregullën 56(2) të Rregullores, paneli siguron që një person të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes. Në rast vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, pasi të ketë dëgjuar palët, paneli mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

#### IV. DISKUTIM

##### A. STANDARDI I ZBATUESHËM

14. ZPS-ja parashtron se vendimi sipas rregullës 57(2) të Rregullores lidhet në mënyrë të pashmangshme me ndryshimin e rrethanave, nëse ka ndonjë ndryshim të tyre, që nga vendimi i fundit mbi paraburgimin.<sup>16</sup> Ajo argumenton gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorët për të cilët tashmë është marrë vendim në vendimin fillestar mbi paraburgimin.<sup>17</sup>

15. Mbrojtja përgjigjet se sipas kornizës ligjore të DHS-së, për të kryer një vlerësim të plotë nëse ende ekzistojnë arsyet për mbajtje në paraburgim, nuk kërkohet të ketë

---

<sup>16</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

<sup>17</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

pasur ndryshim të rrethanave, dhe se mbështetja e ZPS-së në rregullën 57(2) të Rregullores në këtë kontekst është e pavend.<sup>18</sup> Ajo shton se ZPS-ja ka detyrimin për të vërtetuar se paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm.<sup>19</sup>

16. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, sipas nenit 41(10) të Ligjit, ai ka detyrimin të shqyrtojë nëse arsyet për paraburgim vazhdojnë të ekzistojnë, përfshirë arsyet e parashikuara në nenin 41(6) të Ligjit, konkretisht nëse: (i) ekziston dyshim i bazuar se personi ka kryer veprën ose veprat penale; dhe (ii) ka arsye të artikulueshme për të besuar se ndonjëri prej rreziqeve të parashikuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit është materializuar.<sup>20</sup> Detyrimi për të përcaktuar nëse ekzistojnë ende rrethanat mbi të cilat mbështetet paraburgimi i imponon panelit kompetent detyrën që të vlerësojë, *proprio motu*, nëse në kohën e rishikimit dhe në rrethanat konkrete të çështjes kur bëhet rishikimi, është ende i bindur se paraburgimi i të akuzuarit vazhdon të jetë i përligjur.<sup>21</sup> Megjithëse rishikimi automatik çdo dy muaj sipas rregullës 57(2) të Rregullores nuk kufizohet rreptësisht me ndryshimin apo jo të rrethanave, një ndryshim i tillë megjithatë mund të jetë përcaktues dhe duhet marrë parasysh nëse ngrihet nga një palë apo *proprio motu*.<sup>22</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka as detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorë të cilët tashmë janë vendosur në vendimin e parë mbi paraburgimin, dhe as të shqyrtojë parashtrime të cilat thjesht përsërisin argumente të shqyrtuara në vendime të mëparshme.<sup>23</sup> Thelbësore është që në kohën e vendimit të rishikimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake të bindet se ende ekzistojnë arsyet për vazhdimin e paraburgimit.<sup>24</sup> ZPS-ja ka detyrimin të vërtetojë se

---

<sup>18</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 8.

<sup>19</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 4, 8.

<sup>20</sup> KSC-BC-2020-07, IA002-F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit ("Apeli i Paraburgimit të Haradinajt")*, 9 shkurt 2021, publik, para. 55.

<sup>21</sup> KSC-BC-2020-06, IA006-F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit ("Apeli i Paraburgimit të Krasniqit")*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 15. Një version i redaktuar publik u nxor po atë ditë, IA006/F00005/RED.

<sup>22</sup> Apeli i Paraburgimit të Krasniqit, para. 16.

<sup>23</sup> Apeli i Paraburgimit të Haradinajt, para. 55; Apeli i Paraburgimit të Krasniqit, para. 17.

<sup>24</sup> Apeli i Paraburgimit të Haradinajt, para. 55.

paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm.<sup>25</sup> Kjo do të thotë se ZPS-ja duhet të paraqesë argumente specifike dhe prova konkrete për të vërtetuar se në kohën e rishikimit, vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm.

## B. DYSHIM I BAZUAR

17. Lidhur me standardin e vazhimit të paraburgimit, neni 41(6)(a) i Ligjit së pari kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer veprë penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së. Ky është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhimit të paraburgimit të personit të paraburgosur.<sup>26</sup>

18. Sipas ZPS-së, për arsyet e shtjelluara në Vendimin e Konfirmimit dhe Vendimin e Dytë mbi Paraburgimin, vazhdon të ekzistojë dyshim i bazuar mirë se i akuzuari ka kryer një numër veprash penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së.<sup>27</sup> Mbrojtja nuk ka bërë asnjë parashtrim në lidhje me këtë kriter.

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se në Vendimin e Konfirmimit u konstatua që, në pajtim me nenin 39(2) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Shala është penalisht përgjegjës për një numër krimesh lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas nenit 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit.<sup>28</sup> Këto konstatime u bënë në bazë të një standardi më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.<sup>29</sup>

---

<sup>25</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 13, me referenca të tjera.

<sup>26</sup> *Po ashtu*, ECtHR/GJEDNJ, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222, me referenca të tjera.

<sup>27</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 2, 5.

<sup>28</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 140(a). *Shih gjithashtu*, Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 15; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 22.

<sup>29</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 35; *shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, IA008-F00004, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishqyrtimit të Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 21. Një version i redaktuar publik u nxor po atë ditë, IA008/F00004/RED.

20. Në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi të ri në lidhje me këtë vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kriteri i përcaktuar në nenin 41(6)(a) të Ligjit vazhdon të përmbushet.

#### C. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

21. Me përmbushjen e standardit të përcaktuar në nenin 41(6)(a) të Ligjit, arsytet që do të përlligjin heqjen e lirisë së një personi duhet të jenë të artikulueshme, në kuptimin që duhet të specifikohen me hollësi.<sup>30</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton më tej se, në bazë të provave të disponueshme, këto arsye të artikulueshme dhe specifike duhet të mbështesin “besimin”<sup>31</sup> se ekziston ndonjë nga rreziqet e parapara në tre nënparagrafët e nenit 41(6)(b) të Ligjit, që nënkupton pranimin e mundësisë, dhe jo të pashmangshmërisë, që ato të ndodhin në të ardhmen.<sup>32</sup> Me fjalë të tjera, sipas këtij standardi, duhet të tregohet se është më pak se e sigurt, por më shumë se thjesht e mundur, që ndonjë prej këtyre rreziqeve të materializohet.<sup>33</sup> Për të vendosur nëse një person duhet liruar apo mbajtur në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.<sup>34</sup>

---

<sup>30</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin para. 16, me referenca të mëtejshme.

<sup>31</sup> *Shih*, pjesa e përgjithshme e nenit 41(6)(b) i Ligjit.

<sup>32</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 16, me referenca të mëtejshme.

<sup>33</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 16, me referenca të mëtejshme.

<sup>34</sup> KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, 26 prill 2017, publik, para. 114; shih gjithashtu ECtHR/GJEDNJ, Buzadji v. the Republik of Moldova [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016 (“Buzadji v. the Republik of Moldova [GC]”), para. 87 *in fine*; ECtHR/GJEDNJ, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, [Judgment](#), 22 May 2012, para. 140 *in fine*.*



## 1. Rreziku i Arratisjes

22. Sipas ZPS-së, vazhdon të ekzistojë rreziku i arratisjes së z. Shala.<sup>35</sup> ZPS-ja shton se ky rrezik vijon të mbetet i njëjtë ose është shtuar me nxjerrjen e mëtejshme të materialeve sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores pas Vendimit të Dytë për Paraburgimin.<sup>36</sup>

23. Mbrojtja përgjigjet se parashtrimet e përgjithshme të ZPS-së nuk mund të përlligjin vazhdimin e paraburgimit dhe se ZPS-ja nuk ka identifikuar asnjë provë apo bazë konkrete që vërteton se ekziston mundësi reale që z. Shala të paraqesë rrezik arratisjeje.<sup>37</sup> Mbrojtja gjithashtu argumenton se përdorimi i të drejtës së z. Shala për t'u njohur me provat kundër tij – një e drejtë themelore procedurale – si faktor që përlligj vazhdimin e paraburgimit të tij, është thellësisht e padrejtë.<sup>38</sup> Për mendimin e Mbrojtjes, nuk ekziston asnjë rrezik arratisjeje, duke pasur parasysh lidhjen e fortë të z. Shala me Belgjikën, faktin që ai është vetëdistancuar plotësisht nga elitat politike të Kosovës dhe nuk ka ndonjë rrjet përkrahësish, dhe bashkëpunimin e mëparshëm të tij me të gjitha autoritetet gjyqësore dhe hetimore.<sup>39</sup> Mbrojtja gjithashtu fton Gjykatësin e Procedurës Paraprake të rivlerësojë nëse ka rrezik real që z. Shala të arratiset, duke pasur parasysh vendimet e Gjykatës së Apelit që kërkojnë prova dhe konstatime konkrete lidhur me ekzistencën e një rrjeti të pretenduar përkrahësish, me aftësinë e të akuzuarit për të mobilizuar këtë rrjet mbështetës dhe rëndësinë e kundërshtimit të DHS-së nga një i akuzuar në kuadër të nenit 41(6) të Ligjit.<sup>40</sup>

24. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se faktorët që mbështesin argumentin e Mbrojtjes se nuk ekziston rreziku i arratisjes si dhe vendimet e

---

<sup>35</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 5, 6.

<sup>36</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 4.

<sup>37</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 2, 19-20.

<sup>38</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 19.

<sup>39</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 20.

<sup>40</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 21.

lartpërmendura të Gjykatës së Apelit, janë ngritur<sup>41</sup> dhe shqyrtuar më herët në Vendimin e Parë dhe të Dytë për Paraburgimin.<sup>42</sup> Duke rikujtuar se Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk i kërkohet të bëjë konstatime për faktorë për të cilët tashmë është marrë vendim në vendimin fillestar për paraburgimin dhe as të shqyrtojë parashtrime që thjesht përsërisin argumente që janë trajtuar në vendime të mëparshme,<sup>43</sup> nuk është e nevojshme që këto parashtrime të trajtohen më tej.

25. Pas shqyrtimit të faktorëve dhe rrethanave të përshkruara në Vendimin e Parë dhe të Dytë për Paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vazhdon të jetë i bindur se ato ekzistojnë ende. Z. Shala: (i) është në dijeni të akuzave të rënda kundër tij, të mundësisë së marrjes së një dënimi të rëndë për ato akuza në rast se shpallet fajtor dhe të vendimit të formës së prerë për fajësinë e dy anëtarëve të Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët ("NKP") anëtar i së cilës pretendohet se ka qenë edhe ai vetë; dhe (ii) refuzon legjitimitetin e DHS-së.<sup>44</sup> Gjithashtu: (i) madhësia relativisht e vogël e grupit që përbën NKP-në e pretenduar dhe fakti që ngjarjet mbi të cilat mbështeten akuzat janë lehtësisht të dallueshme, e shtojnë mundësinë e ndihmës së ndërsjellë midis anëtarëve të pretenduar të saj, përfshirë edhe duke ndihmuar njëri-tjetrin për t'u arratisur; dhe (ii) ekziston një kontekst i përgjithshëm i një atmosfere të përgjithshme, të rrënjosur dhe të vazhdueshme të ndërhyrjes në proceset penale që kanë lidhje me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") dhe të frikësimit të dëshmitarëve.<sup>45</sup> Këta faktorë dhe rrethana vijnë të vërtetojnë se aktualisht ekziston një rrezik i moderuar që z. Shala të arratiset. Gjithsesi, duke marrë parasysh se këta faktorë dhe rrethana nuk varen nga nxjerrja e materialit mbi të cilin mbështeten akuzat kundër z. Shala, dhe në mungesë të arsytimit konkret të ZPS-së, Gjykatësi i

<sup>41</sup> KSC-BC-2020-04, F00066, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë për Rishikimin e Parë të Paraburgimit*, 1 shtator 2021 ("Parashtrimet e Mbrojtjes të 1 shtatorit 2021"), publike, para. 20-22.

<sup>42</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 24-27; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 27.

<sup>43</sup> Apeli i Paraburgimit të *Haradinajt*, para. 55; Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 17.

<sup>44</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin para. 24-25; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 28.

<sup>45</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin para. 26; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 28.

Procedurës Paraprake gjykon se nxjerrja e materialit shtesë pas Vendimit të Dytë për Paraburgimin nuk e ka shtuar rrezikun e arratisjes.<sup>46</sup>

## 2. Rreziku i pengimit të ecures së procedurave të DHS-së

26. Sipas ZPS-së, rreziku se z. Shala do të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së vazhdon të ekzistojë.<sup>47</sup> ZPS-ja shton se ky rrezik mund të jetë shtuar me marrjen prej tij të materialeve të tjera të nxjerra sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores që nga Vendimi i Dytë për Paraburgimin, dhe rrjedhimisht, tani ai ka njohuri edhe më të mëdha për provat kundër tij.<sup>48</sup>

27. Mbrojtja përgjigjet se përdorimi i të drejtës së z. Shala për t'u njohur me provat kundër tij – një e drejtë themelore procedurale – si një faktor që përlligj vazhdimin e paraburgimit të tij, është thellësisht e padrejtë.<sup>49</sup> Mbrojtja shton se ZPS-ja nuk ka paraqitur prova konkrete që vërtetojnë mundësinë reale se z. Shala do të pengojë procedurat e DHS-së.<sup>50</sup> Gjithashtu, sipas Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë posaçërisht dhe me hollësi ndikimin e masave të shumta mbrojtëse të vendosura në këtë çështje të cilat zvogëlojnë në mënyrë të konsiderueshme çdo rrezik të pretenduar për pengimin e procedurave apo për ndërhyrje të dëshmitarët.<sup>51</sup> Mbrojtja parashtron më tej se lidhja e largët familjare e z. Shala me një dëshmitar, nuk e shton më shumë rrezikun e kontaktimit të këtij personi, duke pasur parasysh masat mbrojtëse në fuqi.<sup>52</sup>

28. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se argumentet e Mbrojtjes lidhur me nxjerrjen e materialeve të tjera, ekzistencën e masave mbrojtëse dhe aftësinë e z. Shala

---

<sup>46</sup> *Po ashtu*, Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 28.

<sup>47</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 2, 5, 6.

<sup>48</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 4.

<sup>49</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 19.

<sup>50</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 23.

<sup>51</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 5, 23, 24.

<sup>52</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 23.

për të ndërhyrë te dëshmitarët, janë parashtruar më herët<sup>53</sup> dhe janë shqyrtuar në Vendimin e Dytë për Paraburgimin.<sup>54</sup> Duke rikujtuar se Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk i kërkohet të bëjë konstatime për faktorë për të cilët tashmë është marrë vendim në vendimin fillestar për paraburgimin dhe as të shqyrtojë parashtrime që thjesht përsërisin argumente që janë trajtuar në vendime të mëparshme,<sup>55</sup> këto parashtrime nuk është e nevojshme të trajtohen më tej.

29. Rikujtohet se, [REDAKTUAR].<sup>56</sup> Ekzistenca e masave mbrojtëse në këtë çështje gjyqësore nuk ndikon në konstatimin se ekziston rreziku i pengimit lidhur me [REDAKTUAR].<sup>57</sup> Gjithashtu, në një kuptim më të përgjithshëm, domosdoshmëria e masave të tilla demonstroi një rrezik të shtuar për pengim, duke pasur parasysh se ngjarjet mbi të cilat mbështeten akuzat janë lehtësisht të dallueshme për shkak të fushëveprimit relativisht të kufizuar të akuzave kundër z. Shala.<sup>58</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton më tej se, duke pasur parasysh [REDAKTUAR], nxjerrja e mëtejshme e materialit inkriminues z. Shala pas Vendimit të Dytë për Paraburgimin e shton rrezikun e pengimit, duke qenë se ndërkohë ai ka më shumë njohuri për akuzat e ZPS-së kundër tij, përfshirë dëshmitarët që ajo do të përdorë në gjykim. Rrjedhimisht, rreziku që z. Shala të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së vazhdon të ekzistojë.

---

<sup>53</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes të 1 shtatorit 2021, para. 18, 25-31.

<sup>54</sup> Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 31-32.

<sup>55</sup> Apeli i Paraburgimit të *Haradinajt*, para. 55; Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 17.

<sup>56</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin para. 32-35; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 35-42; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 32.

<sup>57</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin para. 32-33; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 41; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 31.

<sup>58</sup> Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 31.

### 3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

30. Sipas ZPS-së, rreziku se z. Shala do të kryejë krime të tjera vazhdon të ekzistojë.<sup>59</sup> ZPS-ja shton se ky rrezik mund të jetë shtuar me marrjen prej tij të materialeve të tjera të nxjerra sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores që nga Vendimi i Dytë për Paraburgimin.<sup>60</sup>

31. Mbrojtja përgjigjet se nuk ka prova konkrete që të tregojnë një rrezik mjaftueshëm real se z. Shala do të kryejë krime të tjera, veçanërisht duke mbajtur parasysh masat e shumta mbrojtëse në fuqi.<sup>61</sup>

32. Sikundër përmendet në kontekstin e rrezikut se z. Shala do të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së, parashtrimet e përsëritura të Mbrojtjes në lidhje me ekzistencën e masave mbrojtëse nuk ka nevojë të trajtohen më tej. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton gjithashtu se argumenti i përgjithshëm i Mbrojtjes se nuk ka prova konkrete për të demonstruar një rrezik real të mjaftueshëm se z. Shala do të kryejë krime të tjera, është i pabazuar.

33. Në Vendimin e Parë dhe të Dytë për Paraburgimin u konstatua se ekziston rreziku që z. Shala do të kryejë krime të tjera duke qenë se, [REDAKTUAR].<sup>62</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbetet i vetëdijshëm për faktin se ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, por përsërit se, në çështjen gjyqësore aktuale, faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i parë janë me rëndësi edhe për vlerësimin e këtij të fundit.<sup>63</sup> Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, rreziku që z. Shala do të kryejë krime të tjera vazhdon të ekzistojë duke pasur parasysh se z. Shala [REDAKTUAR]. Gjithashtu, ashtu si me rrezikun e pengimit të procesit, Gjykatësi i Procedurës

---

<sup>59</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 2, 5, 6.

<sup>60</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 4.

<sup>61</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 26.

<sup>62</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin para. 39; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 36.

<sup>63</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin para. 39; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 36.

Paraprake gjykon se nxjerrja e mëtejshme e materialeve shton rrezikun që z. Shala të kryejë krime të tjera.

#### 4. Përfundim

34. Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundim se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Shala të arratiset, të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së, ose të kryejë krime të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarët që i kanë dhënë dëshmi ZPS dhe/ose pritët të paraqiten para DHS-së. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim do të vlerësojë nëse këto rreziqe mund të trajtohen mjaftueshëm duke vendosur kushte lidhur me lirin e përkohshëm të z. Shala.

#### D. LIRIMI ME KUSHT

35. ZPS-ja parashtron se kushtet e propozuara nuk i zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.<sup>64</sup> ZPS-ja shton se këto rreziqe mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së dhe se çfarëdo garancish që mund të japë i akuzuari do të ishin të pamjaftueshme për të garantuar përmbushjen e kushteve apo për të kapërcyer rreziqet konkrete të lirit.<sup>65</sup>

36. Mbrojtja parashtron se nuk ka arsye për të devijuar nga përfundimi se rreziku i moderuar i arratisjes mund të zvogëlohet me vendosjen e kushteve të duhura.<sup>66</sup> Mbrojtja parashtron më tej se, nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se vazhdon të jetë i pranishëm rreziku që z. Shala do ta pengojë procesin apo do të kryejë krime të tjera, çdo rrezik i tillë do të zvogëlohej mjaftueshëm me vendosjen e një numri

---

<sup>64</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

<sup>65</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 7.

<sup>66</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 22, 36.

kushtesh që nuk përfshijnë arrestin shtëpiak (“Kushtet e Propozuara”).<sup>67</sup> Si alternativë ndaj Kushteve të Propozuara, Mbrojtja propozon që z. Shala të mbahet në arrest shtëpiak në vendbanimin e tij në Belgjikë, me kushte të tjera shoqëruese.<sup>68</sup> Së fundi, Mbrojtja kërkon që në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake të urdhërojë paraqitjen e dëshmimeve të ekspertëve në lidhje me monitorimin e komunikimeve në përgjithësi dhe mjetet për një monitorim të tillë nga distanca të disponueshme në Belgjikë, duke përfshirë, nëse gjykohet e nevojshme, parashtrime lidhur me kapacitetet për monitorimin e komunikimeve në gjuhën shqipe.<sup>69</sup>

37. Për sa i takon rrezikut të arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake më parë ka konstatuar se kushtet e propozuara në lidhje me Vendimin e Parë për Paraburgimin, konkretisht, zotimet e z. Shala për t’iu nënshtruar kontrolleve të përditshme të zyrtarëve të autorizuar belgë, për të dorëzuar të gjitha dokumentet e udhëtimit, dhe për t’iu nënshtruar monitorimit të rreptë të autoriteteve belge, e zvogëlojnë mjaftueshëm këtë rrezik.<sup>70</sup> Duke marrë parasysh se parashtrimet e përgjithshme të ZPS-së për këtë çështje nuk bazohen në prova, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në mungesë të një informacioni apo zhvillimi të ri lidhur me vendimin aktual, kushtet e lartpërmendura mbeten të përshtatshme për të zvogëluar rrezikun e arratisjes së z. Shala.

38. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Kushtet e Propozuara dhe mundësia e arrestit shtëpiak me kushte shoqëruese janë ngritur më parë<sup>71</sup> dhe janë shqyrtuar në Vendimin e Parë dhe të Dytë për Paraburgimin.<sup>72</sup> Ndërsa këto parashtrime të përsëritura nuk ka nevojë të shqyrtohen më tej,<sup>73</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake

<sup>67</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 5, 33, 37(i)-(x), 38.

<sup>68</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 4, 5, 7, 23, 24, 25, 32, 33, 37(xi)-(xxiii), 38.

<sup>69</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 7, 34-35.

<sup>70</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 45; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 40.

<sup>71</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes të 1 shtatorit 2021, para. 40.

<sup>72</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 46-48; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 53-58, 61; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 41-42.

<sup>73</sup> Apeli i Paraburgimit të *Haradinajt*, para. 55; Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 17.

kujton gjithsesi se: (i) Kushtet e Propozuara nuk trajtojnë mundësinë që z. Shala të përdorë pajisje komunikimi që u përkasin të tjerëve apo t'u kërkojë të tjerëve të përdorin pajisjet e tyre për këtë qëllim, dhe kushtet e zbatimit janë të pamjaftueshme për të siguruar monitorimin efektiv të komunikimeve të z. Shala duke pasur parasysh rreziqet e identifikuara sipas nenit 41(6)(b)(ii)-(iii) të Ligjit; dhe (ii) mundësia e arrestit shtëpiak dhe kushteve shoqëruese nuk do të parandalonin bisedat e pamonitoruara midis z. Shala dhe vizitorëve të miratuar.<sup>74</sup> Rikujtohet gjithashtu se është përcaktuar që kushtet shtesë, si vizitat e monitoruara nga autoritetet belge, nuk do ta zvogëlonin mjaftueshëm këtë rrezik për shkak të mundësisë së përdorimit të gjuhës së koduar apo të pakuptueshme, të cilën personat që nuk kanë njohuri për procedurat e DHS-së nuk mund ta njohin ose ta parandalojnë lehtë, ndërkohë që komunikime të tilla, përfshirë komunikimet në gjuhën amtare të z. Shala, gjithsesi do t'i nënshtroheshin njëfarë monitorimi në mjediset e kontrolluara të objektit të paraburgimit të DHS-së.<sup>75</sup> Në mungesë të garancive të Belgjikës dhe pasi ka konstatuar se Kushtet e Propozuara, arresti shtëpiak dhe kushtet shtesë janë të pamjaftueshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se nuk ka bazë për të kërkuar informacion të mëtejshëm nga Belgjika.<sup>76</sup>

39. Për më tepër, megjithëse kërkesa e Mbrojtjes për të urdhëruar paraqitjen e dëshmitarëve të ekspertëve nuk ka nevojë të vlerësohet duke qenë se është ngritur<sup>77</sup> dhe trajtuar<sup>78</sup> më parë,<sup>79</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se pamjaftueshmëria e Kushteve të Propozuara, arrestit shtëpiak dhe kushteve shtesë nuk varet vetëm nga

<sup>74</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 46-48; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 53-58; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 41-42.

<sup>75</sup> Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 42; KSC-BC-2020-06, IA010-F00008, Gjykata e Apelit, *Vendimi mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit ("Apeli i Paraburgimit të Thaçit")*, 27 tetor 2021, konfidencial, para. 68. Një version i redaktuar publik u nxor po atë ditë, IA010-F00008/RED.

<sup>76</sup> *Shih gjithashtu*, Apeli i Paraburgimit të Thaçit, para. 64, 67.

<sup>77</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes të 1 shtatorit 2021, para. 41.

<sup>78</sup> Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 43.

<sup>79</sup> Apeli i Paraburgimit të Haradinajt, para. 55; Apeli i Paraburgimit të Krasniqit, para. 17.



komunikimet e z. Shala me anë të pajisjeve të ndryshme dhe, rrjedhimisht, një dëshmi e tillë ekspertësh nuk është e nevojshme për qëllimet aktuale.<sup>80</sup>

40. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbetet i bindur se komunikimet e z. Shala mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e lartpërmendura vetëm përmes zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kushtet e propozuara, arresti shtëpiak dhe çdo kusht tjetër shtesë i vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake janë të pamjaftueshme për zvogëlimin e rrezikut që z. Shala të pengojë procedurat e DHS-së, ose të kryejë krime të tjera.

#### E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

41. ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit të të akuzuarit është proporcional.<sup>81</sup> ZPS-ja argumenton se ndaj z. Shala janë ngritur katër akuza për krime lufte dhe, nëse shpallet fajtor, mund të përballlet me burgim të gjatë, dhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar që rreziqet sipas neneve 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen nga asnjë kusht.<sup>82</sup> Gjithashtu, sipas ZPS-së, pikat procedurale të nevojshme që lidhen me fazën paraprake të çështjes po shkojnë drejt përfundimit me synimin që në një të ardhme të parashikueshme çështja të kalohet për gjykim, dhe se zgjatjet e afateve të nxjerrjes së materialit janë kërkuar dhe/ose rënë dakord nga të dy palët.<sup>83</sup>

42. Mbrojtja përgjigjet se paraburgimi i z. Shala është joproportional.<sup>84</sup> Mbrojtja parashtron se z. Shala, i cili ka të drejtën të prezumohet i pafajshëm, mbahet në

---

<sup>80</sup> Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 43.

<sup>81</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 2, 8.

<sup>82</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 8.

<sup>83</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 8.

<sup>84</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 5, 29.

paraburgim që prej tetë muajsh, ndërkohë që gjykimi i tij realisht nuk do të fillojë para prillit 2022, sipas parashikimit më të hershëm.<sup>85</sup> Sipas Mbrojtjes, periudha e paraburgimit rëndohet nga masat sanitare në lidhje me pandeminë dhe ndërhyrja e tyre në jetën private dhe familjare të z. Shala për shkak të faktit që familja e tij ka mundur ta vizitojë vetëm në tri raste, ndërkohë që përballet me vështirësi të mëdha për ta vizituar përsëri sepse financiarisht varet prej z. Shala.<sup>86</sup> Gjithashtu, Mbrojtja parashtron se z. Shala përballet me vështirësi të përditshme të cilat i shkaktojnë shqetësim dhe ankth.<sup>87</sup>

43. Në fillim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton rëndësinë e parimit të proporcionalitetit në përcaktimin e arsyeshmërisë së paraburgimit para fillimit të gjykimit.<sup>88</sup> Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit është një faktor që duhet marrë parasysh bashkë me shkallën e rreziqeve që përshkruhen në nenin 41(6)(b) të Ligjit, në mënyrë që, duke mbajtur parasysh të gjithë faktorët, të përcaktohet nëse vazhdimi i paraburgimit “pushon së qeni i arsyeshëm” dhe personi duhet të lirohet.<sup>89</sup> Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se vlerësimi nëse periudha e kaluar në paraburgim para fillimit të gjykimit është e arsyeshme, nuk mund të bëhet në kontekst abstrakt. Arsyeshmëria e vazhdimit të paraburgimit të një të akuzuari duhet të vlerësohet në bazë të fakteve të secilës çështje gjyqësore dhe në përputhje me veçoritë e saj specifike.<sup>90</sup>

44. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se: (i) z. Shala është mbajtur në paraburgim në Belgjikë që nga 16 marsi 2021 dhe më pas në objektin e paraburgimit të DHS-së që nga 15 prilli 2021; (ii) ndaj tij janë ngritur katër akuza për krime lufte që

<sup>85</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 3, 28.

<sup>86</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 4, 5, 29-31.

<sup>87</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para 31.

<sup>88</sup> KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të Lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim*, 9 dhjetor 2020, publik, para. 72-73.

<sup>89</sup> Po ashtu, KSC-BC-2020-06, IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 69. Një version i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA002/F00005/RED.

<sup>90</sup> [Buzadji v. the Republik of Moldova \[GC\]](#), para. 90.

pretendohet se kanë ndodhur në Shqipëri gjatë disa javëve; (iii) ai mund të dënohet me burgim të gjatë, nëse shpallet fajtor; (iv) rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen me Kushtet e Propozuara, me arrest shtëpiak dhe/ose ndonjë kusht tjetër shtesë; (v) të gjitha hapat proceduralë që lidhen me fazën paraprake të kësaj çështjeje gjyqësore kanë përfunduar, po përfundojnë, ose do të përfundojnë, me synim kalimin e çështjes për gjykim në një të ardhme të afërt – në veçanti, ZPS-ja pothuajse e ka përfunduar nxjerrjen e materialeve të saj sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores (përfshirë dokumentet shtesë sipas një vendimi të Gjykatësit të Procedurës Paraprake),<sup>91</sup> është bërë përparim i mëtejshëm në procesin e nxjerrjes së materialit sipas rregullave 102(3), 103 dhe 107 të Rregullores,<sup>92</sup> dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka caktuar afat kohor për dosjen paraprake të ZPS-së dhe ka nxjerrë dy vendime në lidhje me mocionet paraprake të Mbrojtjes;<sup>93</sup> dhe (vi) afatet kohore përkatëse ose janë respektuar, ose janë zgjatur për arsye të vlefshme – në disa raste edhe me kërkesë të z. Shala – dhe çdo kërkesë shtesë për zgjatjen e afateve do të vlerësohet sipas kritereve ligjore përkatëse.<sup>94</sup> Gjithashtu, në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) e Rregullores, paraburgimi i z. Shala rishikohet çdo dy muaj apo kur ka ndryshim të rrethanave.

<sup>91</sup> KSC-BC-2020-04, F00080, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën e Tretë mbi Ecurinë e Çështjes*, 17 shtator 2021, publik, para. 1; Transkripti, 23 shtator 2021, publik, f. 71, rreshtat 2-19, f. 76, rreshtat 8-15; F00100, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Leje për Nxjerrje të Materialit Shtesë sipas Rregullës 102(1)(b) të Rregullores*, 4 nëntor 2021, publik; F00102, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën e Katërt mbi Ecurinë e Çështjes*, 9 nëntor 2021 (“Parashtrimet e ZPS-së të 9 nëntorit 2021”), konfidenciale, para. 1 (një version i redaktuar publik u nxor po atë ditë, F00102/RED).

<sup>92</sup> Parashtrimet e ZPS-së të 9 nëntorit 2021, para. 2-8.

<sup>93</sup> KSC-BC-2020-04, Transkript, 23 shtator 2021, publik, f. 92, rreshtat 10-20; F00088, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionin që ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara*, 18 tetor 2021, publik; F00089, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 18 tetor 2021, konfidencial (një version i redaktuar publik u nxor po atë ditë, F00089/RED).

<sup>94</sup> *Shih për shembull*, KSC-BC-2020-04, F00074, *Mbrojtësi i Specializuar, Mocion i Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit për Kërkesën e saj sipas Rregullës 102(2) [sic]*, 9 shtator 2021, publik; KSC-BC-2020-04, F00076, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj KSC-BC-2020-04/F00074 dhe Kërkesë e lidhur me të për Modifikimin e Afateve*, 10 shtator 2021, publike; KSC-BC-2020-04, Transkripti, 23 shtator 2021, publik, f. 92, rreshtat 10-20; KSC-BC-2020-04, F00086, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Kërkesën e saj sipas Rregullës 102(2) [sic]*, 13 tetor 2021, publike.

45. Për sa u takon parashtrimeve të Mbrojtjes për masat sanitare në lidhje me pandeminë dhe ndërhyrjen e tyre në jetën private dhe familjare të z. Shala, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se pamundësia e vizitave të rregullta familjare ishte një masë proporcionale dhe e përkohshme, e domosdoshme për shkak të shqetësimeve në lidhje me shëndetin publik, se z. Shala është lejuar të komunikojë me familjen në mënyra të tjera, dhe se këto kufizime tani janë hequr.<sup>95</sup> Për më tepër, shpeshësia e vizitave familjare nuk mund t'i atribuohet DHS-së dhe, gjithsesi, z. Shala vazhdon të ketë mundësi të komunikojë me anëtarët e familjes së tij në mënyra të tjera. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se parashtrimet lidhur me shqetësimet dhe ankthin e përjetuar nga z. Shala nuk janë të bazuara në fakte dhe gjithsesi atyre nuk duhet t'u jepet shumë peshë, duke pasur parasysh akuzat e rënda të ngritura kundër z. Shala dhe ekzistencën e rreziqeve të lartpërmendura sipas nenit 41(6)(b)(ii)-(iii) të Ligjit.

46. Mbi këtë bazë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se koha që z. Shala ka kaluar në paraburgim para fillimit të gjykimit nuk është joproporcionale. Gjithashtu, duke marrë parasysh se nuk është arritur ende një marrëveshje për fillimin e gjykimit,<sup>96</sup> çdo diskutim lidhur me kohëzgjatjen e gjithsejtë të pritshme të paraburgimit paraprak të tij mbetet i parakohshëm dhe hamendësues.<sup>97</sup>

## V. VENDIM

47. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

(a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Shala;

(b) **URDHËRON** Mbrojtjen që, në rast se dëshiron, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala, jo më vonë se të

---

<sup>95</sup> Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 48.

<sup>96</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 3.

<sup>97</sup> *Shih gjithashtu*, Apeli i Paraburgimit të *Krasniqit*, para. 43; Apeli i Paraburgimit të *Thaçit*, para. 51.

**premten, 17 dhjetor 2021**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe

(c) **URDHËRON** ZPS-në që, në rast se z. Shala vendos të mos paraqesë parashtrime deri në afatin e përcaktuar më lart, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala, jo më vonë se të **enjten, 23 dhjetor 2021**, dhe z. Shala që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrimet e tij jo më vonë se të **mërkurën, 5 janar 2022**.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

E mërkurë, 10 nëntor 2021

Në Hagë, Holandë.